



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:031611

Datë: 16.11.2023

Numri i dokumentit: 04928892

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.806/23

GJYKATA THEMELORE PEJË- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Leon Përlaska dhe procesmbajtësen Shpresa Kërnja, në çështjen penale kundër të pandehurit D. B. nga Peja ,për veprën penale Vjedhje nga neni 313 par.1 te Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr.221/22 të datës 16.02.2022 dhe aktakuzës PP/II.nr.1528/21 të datës 31.12.2021 (lëndë të bashkuara) , në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 31.10.2023, në prezencë të prokurorit të shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit D. B. me mbrojtësin të tij Av.Gani Kelmendi, me datë 31.10.2023 e shpalli ndërsa me datë 16.11.2023 përpiloi këtë :

AKTGJYKIM

I pandehuri:

D. B., i lindur me, në Pejë, ku dhe ka vendbanim të përhershëm Rr.A. J. hyrja nr. kati nr.3 nr.12, i biri i S. dhe Xh., e gjinisë A. i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të lnj.nr. personal- Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me datë 16.12.2020, rreth orës 11:30 minuta, në Rr. “Y. B.” në Pejë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, të miturit S.V. – djalit te dëmtuarës H. V. ia merr pasurinë e luajtshme dhe atë telefonin e markës Iphon 6 +, ngjyrë hiri, në vlerë prej 200 €, e në të cilin

ishte i vendosur nr. 045/ 403-467, ashtu që i pandehuri takohet me të miturin S.V. të cilit ja kërkon telefonin e lartcekur me arsyetimin për ta shfrytëzuar për një thirrje telefonike, e më pas largohet nga vendi i ngjarjes në drejtim të panjohur, duke mos ja kthyer telefonin e tij, e po ashtu të njëjtin telefon i pandehuri ia shet dikujt tjetër,

- me çka ka kryer vepër penale Vjedhje nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Me dt. 08.12.2020, rreth 19:00, në rr. "A. Gj." në Pejë, pikërisht në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit B. K., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete merr biçikletën e të dëmtuarit e markës " SCOT", në vlerë prej 50 €, në atë mënyrë që i pandehuri hynë në oborrin e të dëmtuarit, ku nga aty merr biçikletën e lartcekur, e më pas largohet nga vendi i ngjarjes, ku gjatë largimit vajza e të dëmtuarit e vërejnë të pandehurin duke e drejtuar biçikletën e tyre por nuk reagon sepse ka menduar që e ka marr me lejen e prindërit të saj, po ashtu të njëjtën biçikletë ia shet dikujt tjetër.

- me çka ka kryer vepër penale Vjedhje nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Me datën 17.12.2021 rreth orës 03:00 në Pejë, Rr. "V. K." me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej 50 euro apo më shumë dhe atë të dëmtuarës D.L., në atë mënyrë që pasi e dëmtuara përmes rrjetit social komunikon me të pandehurin D., sipas kërkesës së këtij të fundit takohen në adresë të lartcekur dhe aty telefonin e markës Iphone 8+, të cilin e dëmtuar e kishte me vete ,pa dëshirën e saj ia merr i pandehuri duke i thënë se do t'ia kthej pas disa ditëve, por i njëjti telefonin në fjalë nuk i a kishte kthyer për çka e dëmtuara e lajmëron rastin në polici.

- Me çka ka kryer vepër penale Vjedhje nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 43,46, 48, 49, 69, 70 dhe 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

Të pandehurit D. B. , për veprat penale në vazhdim, si në pikën I., II dhe III. të këtij aktgjykimi i shqipton:

- I. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj si dhe DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 300 (treqind) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 vitesh, qe do të llogaritet nga momenti i plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Obligohet i dënuari qe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.
- III. Kërkesë pasurore juridike nuk pati nga të dëmtuarit.

ARSYETIM

A) Historiku i çështjes, qëndrimet e palëve dhe fajësia ;

Prokuroria Themelore në Pejë pranë kësaj gjykatë ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.221/22 të datës 16.02.2022 dhe aktakuzën PP/II.nr.1528/21 të datës 31.12.2021 kundër të pandehurit D. B. për shkak të veprave penale Vjedhje nga neni 313 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074).

Gjykata me datë 31.10.2023 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën seancë prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku i pandehurit D. B. me mbrojtësin të tij Av.Gani Kelmendi.

Me pëlqimin e palëve dhe në kuptim të nenit 34 par.1 , 7 dhe 8 të KPPRK-së gjykata e bëri bashkimin e procedurës penale sipas aktakuzave PP/II.nr.221/22 të datës 16.02.2022 dhe aktakuzën PP/II.nr.1528/21 të datës 31.12.2021, të cilat lëndë në gjykatë e mbanin numrin P.nr.806/23 dhe P.nr.2/22, te dyja këto lëndë u proceduan së bashku nën numrin e lëndës P.nr.806/23.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit dhe pasi që gjykata u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohet e ftoi të njëjtin që të deklarohet në lidhje me fajsinë, ku i pandehuri D. B. e pranoi fajsinë për veprat penale që i vihen në barrë.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri, gjykata e mori mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të të pandehurit në lidhje me pranimin e fajësisë të cilët i propozuan gjykatës që të aprovohet pranimi i fajësisë.

Gjykata duke u bazuar në nenin 242 par 2 dhe 6 të KPPRK-së vlerësoj se plotësohen kushtet ligjore për pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuzën dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuzën nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike, andaj gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë si të tillë.

B) Vendimi në lidhje me dënimin;

Gjykata kur vendosi në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit të përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në nenet 38, 39, 40, 42, 43, 46, 48, 49, 69, 70 dhe 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074), dhe atë duke pasur parasysh qëllimin e dënimit, rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të nxjerra nga faktet e çështjes dhe duke aplikuar udhëzuesin për politikë ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Kosovës, si në vijim.

1. Përcaktimi i dënimit kryesor;

Kur vendosi në lidhje me dënimin kryesor gjykata u mbështet në nenin 40 par.1 pika 1.2 dhe nenin 42 par.1 si dispozita të përgjithshme dhe dispozitën e veçantë nga neni 313 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) që e përcakton veprën penale Vjedhje dhe dënimin për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri.

Neni 313 par 1 i KPRK-së, përveç që përcakton veprën penale e përcakton edhe minimumin dhe maksimumin e dënimit me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet, ku pastaj gjykata duke u mbështetur në rrethanat e rastit konkret bëri individualizimin e dënimit për të pandehurin D. B.

2. Vlerësimi i provave dhe argumenteve të palëve për rrethanat renduese dhe lehtësuese;

Duke pasur parasysh se në këtë çështje penale i pandehuri e pranoi fajësinë në fillim të shqyrtimit fillestar, gjykata nuk e pati mundësinë që të administroj provat e propozuara në aktakuzë, megjithatë me rastin e vlerësimit të pranimin të fajësisë dhe pas shikimit të shkresave të lëndës nga provat e bashkëngjitura dhe deklaratimet e palëve në seancën e shqyrtimit fillestar gjykata arriti që të nxjerr rrethanat të cilat janë përcaktuese për llojin dhe lartësinë e dënimit.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit deklaroi “Meqenëse i akuzuari D. B. , e pranoj fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet dhe një gjë të tillë e bëre konform kushteve ligjore të parapara me neni 242 të KPPRK-se, dhe në përputhje të plote me të gjitha provat materiale dhe personale me të cilat mbështetë kjo aktakuzë , nga gjykata kërkoj që të njëjtin ta shpallë fajtorë, ta dënoj sipas ligjit dhe të obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa në rastin e përcaktimit në llojin dhe lartësinë e dënimit, pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethane lehtësuese, ndërsa në kuptim të dispozitave ligjore të nënti 70 të KPRK-së si rrethana renduese të vlerësoj shkallën lartë të pjesëmarrjes të kryerjes veprave penale me qenë se i njëjti në vazhdimësi ka kryer vepra penale të vjedhjes, shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprave penale, nga se këtu i akuzuari ka qenë i vetëdijshëm se me veprimet e tij po shkaktonte pasoja ligjore të ndaluara me Ligj, mirëpo edhe përkundër kësaj i njëjti është dakorduar dhe ka dashur që këto pasoja të shkaktohen, si dhe fakti se i njëjti është recidivist i posaçëm i veprave penale të vjedhjes, e po ashtu kemi më shumë persona të dëmtuar, prandaj me qëllim të risocjalizimit dhe rehabilitimit të tij nga Gjykata kërkoj që ndaj të njëjtit të shqiptoj një dënim më të rëndë”.

I dëmtuari A. L. deklaroi “Unë kuptoj se rinia gabojnë mirëpo edhe ky duhet me u përmirësu, unë kam kërkuar prej D. për me kthyer telefonin por nuk ma ka kthyer, unë veç i kisha kërku D. për me përmirësua veten dhe sa përket rastit tim unë isha pajtu që gjykata me i dhënë edhe dënim me kusht”.

Mbrojtësi i të pandehurit D. B. av.Gani Kelmendi, pas aprovimit të fajësisë nga gjykata u deklarua në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit theksoi se “Me qenëse i mbrojturi im në

mënyre vullnetare pranoj fajësinë, për veprat është penduar dhe nuk do të përsërisë veprat e tilla, i ka kryer kur ka qenë në moshë të re dhe i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha këto rrethana dhe të mbrojturit ti ti shqiptohet një dënim me kusht ”.

I pandehuri D. B. ne seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi “ Jam i penduar thellësisht për këto vepra që i kam bo, në atë kohë kam qenë përdorues i narkotikëve dhe i premtoj gjykatës që asnjëherë ma nuk do kryerja vepra që do të bien ndesh me ligjin, palës së dëmtuar i kërkoj falje”.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin si rrethane renduese na paraqitet fakti se i pandehuri është përsëritës i veprave penale te kësaj natyre, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi qe ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit te dënimit me burgim gjykata u bazua ne nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurit do të arrihet të realizohet në tersi qëllimi i dënimit, pasi qe ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit . Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej dy vitesh do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënimi me burgim dhe gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz qe të parandaloj të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjithashtu gjykata vlerësoj faktin se i pandehuri në kohen e gjykimin gjendet ne vuajtje të dënimit për vepra penale të të njëjtës natyrë të cilat i ka kryer pothuajse në të njëjtën kohe me veprat për të cilat gjykohet, gjithashtu ne zyrën time si gjyqtar ndaj të njëjtit të pandehur kam shqiptuar dënim me burgim me dy aktgjykime të ndryshme, për vepra penale të natyrës së njëjtë dhe në kohën përfaqësisht të njëjtë, andaj vlerësoj se shqiptimi i dënimeve të vazhdueshme, te përsëritura më burgim, për kohen e njëjtë të kryerjes, nuk i shërben qëllimit të risocializimit, përkatësisht në aspektin material të dënimit është në kundërshtim me frymën qëllimit të dënimit.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e në këtë rast siç u përshkrua më lartë për veprën penale që është shpallur fajtor i pandehuri është parapare mundësia e shqiptimit të dënimit me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vit.

C. Dënimi me gjobë;

Gjykata në dispozitiv të këtij aktgjykimi ka vendosur gjithashtu që ndaj të pandehurit D. B. të shqiptoj edhe dënim me gjobë në lartësi prej 300 (treqind) euro, i cili dënim së bashku me dënimin më burgim është kushtëzuar për kohën e verifikimit prej dy vitesh, që llogaritet nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Dënimin më gjobë gjykata e shqiptoj duke u bazuar në faktin se për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë shqiptimin e dënimit me gjobë dhe me burgim në mënyrë kumulative, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 43 par.1 dhe 2 të KPRK-së vendosi që të pandehurit t’i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, më bindjen se ky dënim së bashku me dënimin me burgim, do të arrijnë në mënyrë të mjaftueshme të shprehin gjykimin shoqëror për veprën e kryer.

D. Dënimi për veprën penale në vazhdim;

I pandehuri D. B. është shpallur fajtor për veprën penale Vjedhje nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, e cila veprë realisht është e kryer përmes disa veprave penale si të veçanta, përkatësisht i pandehuri me ndërmarrjen e disa veprimeve të ndara i ka kryer disa vepra penale me disa të dëmtuar, mirëpo gjykata të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim për veprën penale në vazhdim dhe atë në kuptim të nenit 77 par.1 të KPRK-së.

Vendimi i gjykatës për shqiptimin e dënimit për veprën penale në vazhdim mbështetet në faktin se gjykata gjeti lidhshmëri kohore ndërmjet veprave penale për të cilat është shpallur fajtor i pandehuri dhe se në veprimet e të pandehurit D. B. janë shprehur edhe elemente të tjera të cilat e formësojnë veprën penale në vazhdim, e që janë objekti i njëjtë i veprës penale që ka të bëjë me të mirë në mbrojtur përkatësisht faktin se objekt i këtyre veprave penale është pasuria dhe dashja e njëjtë e kryerësit.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit D. B. është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale të kryera nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Kërkesë pasurore juridike nuk pati nga të dëmtuarit, andaj gjykata as nuk vendosi për kërkesën e as nuk i udhëzoi palët në kontest civil.

Andaj, duke u mbështetur në fakte, provat dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.806/23, me datë 16.11.2023

Procesmbajtësja:
Shpresa Kërnya

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.